

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik i Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028, Bashkia Durrës.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë.

Qëllimi: Konsultim publik me banorët, grupet e synuara të interesit ato të marginalizuara e më gjerë të Bashkisë Durrës, ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me ndryshimet apo propozimet për ndryshime të Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet **online në faqen web të bashkisë Durrës për periudhën 1 Gusht – 20 Gusht 2025.**

Sugjerimet/komentet/rekomandimet janë të mirëpritura deri më datë 22 Gusht 2025, në adresat e emailit:

nikoleta.rusha@durres.gov.al

keshillidurres@gmail.com

Pjesëmarrës:

- Këshilli Bashkiak dhe Administrata e Bashkisë Durrës
- Banorët e Bashkisë Durrës, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, gjimnazet, mësuesit, përfaqësues të komuniteteve fetare në Durrës, grupe të ndryshme interesi apo grupet e marginalizuara, etj.

Forma e konsultimit: Online.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik synon përfshirjen e mendimeve, sugjerimeve dhe rekomandimeve të komunitetit lidhur me Planin e Arsimit Parauniversitar 2026-2028 të Bashkisë Durrës. Ky proces është një mundësi e rëndësishme për qytetarët të japin mendimet e tyre pasi ndihmon të hartohet një plan i cili do të garantojë një sistem arsimor të barabartë, gjithëpërfshirës dhe cilësor për çdo fëmijë dhe të ri në territorin e Bashkisë Durrës, përmes zgjerimit të aksesit, fuqizimit të institucioneve edukative si qendra komunitare, rritjes së kapaciteteve profesionale dhe mbështetjes së diferencuar për grupet në nevojë, me synim ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, të zhvilluar dhe të qëndrueshme.
Përshkrimi i çështjes.	Miratimi i Planit mbështetet në parime të forta si 1. Zgjerimi dhe barazimi i aksesit në arsim: Kjo shtyllë synon të garantojë që çdo fëmijë dhe i ri në territorin e Bashkisë Durrës, pavarësisht zonës ku jeton, gjinisë apo statusit social-ekonomik, të ketë mundësi të barabartë për të ndjekur një institucion arsimor. 2. Përmirësimi i cilësisë së mjedisit mësimor dhe infrastrukturës: Përmes investimeve në orendi, pajisje, kondicionerë, laboratorë dhe ambiente funksionale, synohen kushte të sigurt, të rehatshme dhe të motivuara për mësimdhënie dhe të nxënie.

	3. Gjithëpërfshirja dhe mbështetja e grupeve në nevojë: Një nga drejtimet thelbësore të vizionit është ndërtimi i një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, që nuk përjashton asnjë fëmijë për shkak të moshës, aftësive ndryshe, përkatësisë etnike apo gjendjes ekonomike. Prania e mësuesve ndihmës, investimet në konvikte dhe pajisje mbështetëse, si dhe përqendrimi në kopshtet publike, përbëjnë mekanizma për të forcuar përfshirjen sociale dhe barazinë në arsim. 4. Ndërtimi i objekteve të integruara, rikonstruksioni i plotë i shkollave dhe pajisja me mjete bashkëkohore janë indikatorë të qasjes komunitare që synon plani.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit më poshtë, BRENDA DATËS 22 Gusht 2025. nikoleta.rusha@durres.gov.al keshillidurres@gmail.com
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me cështjen që konsultohet.	Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen Web të bashkisë, faqja kryesore. https://durres.gov.al/category/bashkia/njoftime/
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e Komisionit Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit të çdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në plan dhe në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 7. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 8. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	01.08.2025